



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 24.04.2013
Nr. 0204 - 429

PËR: Blerim Kuçi, Kryetar i Komunës së Suharekë
Veseli Maliqaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekë

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË SUHAREKË, 01 Nr. 2324, Pranuar me datë, 08.04.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 2324, të miratuar me datë 29.03.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 Nr. 2324 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave nga palët e pakënaqura ofertuese, pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 24.04.2013

Br. 0204-429

Za: Bljerim Kuçi, Gradonačelnik Opštine Suva Reka
Veselj Malićaj, Predsedavajući Skupštine Opštine Suva Reka

PREDMET: POTVRDA O ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE SUVA REKA,
01Br.2324, Primljeno dana, 08.04.2013.

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke 01 br.2324, usvojene dana 29.03.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt niže naveden, ima puni pravni efekat .

- Odluka 01br.2324, za formiranje komisije za razmatranje kalbi od nezadovoljnih stranaka ponudjivača, posle finalne procene izbaranih ponuda od strane komisije za davanje na korišćenje nepokretne opštinske imovine.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava
Arhivi MALS-a.



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008, neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 9 pika 3, lidhur me pikën 4, të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 35/2012), Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 29.03.2013, mori këtë:

V E N D I M
 Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana komisionit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, për periudhën afatshkurt dhe afatgjatë

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbëhet prej 3, (tre) anëtarëve në këtë përbërje:

1. Nexhat Ramadani -----anëtar-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
2. Nadire Hoxha-----anëtare-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
3. Gezim Gega -----anëtar-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës

Neni 3

Detyra dhe përgjegjësit e komisionit janë që të bëjnë shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana komisionit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, për periudhën afatshkurt apo afatgjatë, ku komisioni lidhur me ankimin vendosi me vendim në këtë mënyrë:

- 3.1 refuzimin e ankesës dhe lënia në fuqi të procesit të vlerësimit final të ofertës
- 3.2 miratimin e ankesës dhe shfuqizimin, revokimin e procesit të vlerësimit final të ofertës

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoutëtin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008), nenit 18, të Rregullores, Nr-01/2013 për procedurat e hartimit dhe publikimit e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-16-2324
 Me datë 27-04-2013



Kryesuesi i Kuvendit
 Vesel Maliqaj